



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 12962 Prot

Vlorë, më 15.08 2024

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ . 2024

**PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023 "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2024" I NDRYSHUAR**

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, VKM nr. 503, datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM Nr. 421, datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 325, datë 31.05.2024 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", VKB nr. 100 datë 29.12.2023, "Për miratimin Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024", VKB nr. 92, datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2024" i ndryshuar, shkresën nr. 6439/1 prot. datë 13.08.2024, hyrë në Bashki me nr. 12829/1 prot. datë 14.08.2024 "Kthim përgjigje" dhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit në numrin e punonjësve të Administratës së Bashkisë Vlorë, si pasojë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si më poshtë:

Administrata e Bashkisë Vlorë ishte 318 punonjës – bëhet 323 punonjës

2. Miratimin e ngritjes së Njesisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve në Bashkinë Vlorë, klasës dhe shtesës për pozicion të pagës, si më poshtë:

## Njësia e Koordinimit të Proçesit të Legalizimeve

Pozicioni	Klasa	Shtesa per pozicion
Specialist	IIIB	63,000

3. Shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën 2% për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, llogaritet mbi shtesën e nivelit të kualifikimit.
4. Fondi i pagës për punonjësit e Njesisë së Koordinimit të Proçesit të Legalizimeve do të pasqyrohet në ndryshimet e Buxhetit të Bashkisë Vlorë 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**







REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA VLORE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 12962 prot.

Vlorë, më 15 .08 2024

**RELACION**

**PËR PROJEKTVEEDIMIN “PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023 “PËR  
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË  
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA  
– 2024” I NDRYSHUAR”**

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Miratimi i ndryshimit në numrin e punonjësve të Administratës së Bashkisë Vlorë, vjen si pasojë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për ngritjen së Njesisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve në Bashkinë Vlorë. Njësia ngrihet për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë dhe të trajtimit me prioritet të procedurave administrative të papërfunduara për legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat me prioritet zhvillimi urban dhe zonat informale banimi.

Për këtë qëllim Bashkia Vlorë ka zhilluar takime me përfaqësues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe u vlerësua krijimi Njesisë e Koordinimit të Procesit të Legalizimeve e përbërë prej 12 punonjësish. Bazuar në nenin 5 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, 5 punonjës në këtë njësi do të jenë pjesë e Administratës së Bashkisë Vlorë dhe 7 punonjës do të jenë pjesë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të cilët Bashkia do të transferojë fond për të mbuluar shpenzimet e pagave.

Në nenin 6 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, janë parashikuar angazhimet e të dy palëve për funksionimin e Njesisë së Koordinimit të Procesit të Legalizimeve për Bashkinë Vlorë.

Për sa më sipër, Bashkia Vlorë i drejtohet Këshillit Bashkiak me këtë Projektvendim “Për një shtesë VKB nr. 92, datë 24.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024” i ndryshuar”.

Ju faleminderit!

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

